



VENDIM

Nr. 73, Datë 27.05.2016

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR LIÇENSIMIN E SHOQËRISË
“REKA ENERGY” SH.P.K, NË AKTIVITETIN E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE NGA HEC –ET “ZAJE” ME FUQI 220 KW,
“TURAJ” ME FUQI 320 KW, “XHAFERAJ-MESHTEKEN” ME FUQI
3680 KW, “NOVOSEJ” ME FUQI 220 KW, DHE “KOLLOVOZ” ME
FUQI 1500 KW(ME FUQI TOTALE 5940 KW)**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2 gërma “a” dhe 110 të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 4, pika 1, gërma “a”; 5, pika 1 gërma “a”; 10 pika 3 të Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 108, datë 09.09.2008 dhe nenit 18 pika 1 gërma “a” e Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21 datë 18.03.2009, te ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 27.05.2016, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “REKA ENERGY sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut për licensimin e kësaj shoqërie në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike,

Konstatohet se :

Aplikimi i shoqërisë “REKA ENERGY” sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në Rregulloren për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1 gërmat “a”, “b” dhe “c”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2, gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”, “f”, “g”) është plotësuar në mënyrë korrekte;
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3, gërma “d”) është plotësuar në mënyrë korrekte;

- Dokumentacioni tekniko – ekonomik (neni 9, pikat 4.1.3; 4.1.4 gërmat “a”, “b” dhe “c”; 4.1.5 gërmat “b” dhe “c”), është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit që ka të bëjë me:

- Bilancin Financiar; vërtetimi për shlyerjen e tatim – taksave dhe dokumentat që vërtetojnë aftësinë ose mbështetjen financiare të aplikuesit (neni 9 pika 3 gërmat “a”, “b” dhe “c”)
- Të dhënat teknike për secilin Hec; të dhënat teknike për bllokun e transformimit dhe lidhjen me sistemin dhe miratimi i pikës së lidhjes (neni 9 pikat 4.1.1, 4.1.2, 4.1.4 gërma “d” dhe 4.1.5 gërma “a”),

do të njoftohet subjekti që në bazë të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/ të Pjesëbëm dhe Rinovimit të Liçensave”, neni 10, pika 10 dhe neni 11, pika 1, t’i paraqesë këto në ERE, brenda afateve të përcaktuara.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurat për licensimin e shoqërisë “REKA ENERGY” sh.p.k., në aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike nga Hec-et “Zaje” me fuqi 220 KW. “Turaj” me fuqi 320 KW, “Xhaferaj-Meshteken” me fuqi 3680 KW, “Novosej” me fuqi 220 KW, “Kollovoz” me fuqi 1500 KW(me fuqi totale 5940 KW).
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Liçensuarve të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE
Petrit AHMETI